

RAPORTI MBI ECURINË E VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

GFI ALBANIA sh.p.k

Gjatë vitit 2022 është shënuar një ecuri e qëndrueshme për GFI Albania sh.p.k (në vijim referuar si " GFI Albania " ose "Shoqëria"). Shoqëria i është përgjigjur me sukses sfidave të lidhura me kërkesën për markimin dhe monitorimin e karburanteve në Republikën e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2022, të ardhurat e Shoqërisë nga aktiviteti i shfrytëzimit kanë qenë 430,347,939 Lekë.

AKTIVITETE NË FUSHËN E KËRKIMIT DHE ZHVILLIMIT

GFI Albania shpk operon në tregun shqiptar si një kompani me risk të limituar, sipas Kontrates Koncesionare datë 27.02.2013, Nr. 14859/23 Prot, "Per Sherbimin e Markimit dhe te Monitorimit te Karburanteve ne RSH".

GFI Albania sh.p.k kërkon risi të vazhdueshme me qëllim të vazhdimit të përmirësimit të shërbimit që ofron, zgjidhjeve që ai zhvillon dhe ofron. Në këtë drejtim, GFI Albania sh.p.k investon në kërkime dhe zhvillim dhe investon në aksesimin e teknologjisë së re dhe inovative dhe përmirëson vazhdimisht linjat ekzistuese për të mbetur konkurrues në treg.

Të udhëhequr nga nevojat e klientëve, kompani zgjedh dhe aplikon aftësi inxhinierike dhe teknologji të reja në proceset e tyre të ofrimit të shërbimeve.

Ne jemi të inkurajuar dhe krenarë për përparimin që po bëjmë. Ne jemi të emocionuar për atë që e ardhmja do të na rezervojë.

a) Rreziqet e biznesit

Duke qenë se shërbimet e ofrimit të markimit dhe monitorimit në Republikën e Shqipërisë janë të detyrueshme të kryhen në mënyrë të vazhdueshme sipas specifikimeve në legjislacion, risku i biznesit mbetet i ulët.

b) Blerja e aksioneve të veta

Kapitali aksionar i autorizuar dhe i regjistruar i Shoqërisë është 10,000,000 Lekë e cila është ndarë në pronësi të aksionarit kryesor PETROLEUM CONSULTING PARTNERS LLC me 99,93 % të kapitali themeltar dhe SICPA Global Fluids Integrity SA me 0.07%.

Gjatë vitit 2022 nuk ka pasur ndryshime në strukturën e kapitalit të shoqërisë apo në vlerën e kontributit aksionar.

c) Degët e Shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin në adresën kryesore Autostrada Tiranë - Durrës, Km.6, Godinë, Zona Kadastrale Nr.2679, Nr.Pasurie 11/41, Tiranë, Shqipëri dhe në adresat si më poshtë : Porti i Porto Romano, Durres, Vlorë Porti i Petrolifera, Narte Durres Porti i Porto Romano, Durres, Terminali EuroPetrol Durres Albania sh.a, Korce Pika Doganore Kapshtice, Durres Porti i Porto Romano, Terminali Eroil sh.a Porti i Porto Romano, Durres, Terminali Porto Romano Oil sh.a Porti i Porto Romano, Terminali Genklaudis sh.a, Durres, Pika Doganore Kakavije.

d) Politikat dhe objektivi i administrimit të riskut financiar, ekspozimi i Shoqërisë ndaj risqeve financiare & sasive të riskut

Politikat dhe Objektivat për administrimin e rreziqeve financiare, si dhe sasitë përkatëse, përfshihen në shënimet e Pasqyrave Financiare.

